



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1045/4 Prot.

Tiranë, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 25, datë 28.03.2023

PËR

“MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË, TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË DHE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”

Në zbatim të neneve 3, shkronja ç), 47 dhe 49 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Vendimit të KM-së nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” i ndryshuar; të neneve 49 dhe 51 të Statutit të UMT-së; të Rregullores së UMT-së; të nenit 4, pika 1, shkronja m), të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Administrimit të UMT-së”, si dhe të Vendimit të Senatit Akademik nr. 20, datë 10.03.2022, në mbledhjen e datës 28.03.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimeve të ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë të studimeve, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për vitin akademik 2023-2024, sipas tabelave 1, 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Studentët e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë të studimeve i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si përsëritës i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet. Student përsëritës konsiderohet student i cili nuk ka plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve për të kaluar në vitin pasardhës.

3. Studentët e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” të cilët nuk e kanë përfunduar programin përkatës të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, brenda kohëzgjatjes normale të tij, dhe konsiderohen studentë mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik tarifën për kredit për lëndët përsëritëse.
4. Studentët, që transferojnë studimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.
5. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në një program të parë apo të dytë studimi, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në programet respektive, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të institucionit.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

ANËTARË

MONIKA FIDA



ANIS THODHORJANI

VERA OSTRENI



ALTINA XHAFERI



ALBANA GJINOPULLI



ENDRIT YZEIRAJ

